



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 50 dt.08.05.1995

MBI DISA EMERTIME NE RRUGET DHE SHESHET E TIRANES

Këshilli Bashkiak i qytetit të Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin e Seksionit të Kulturës “Mbi disa emërtime rrugësh dhe sheshesh të Tiranës”. Në mbështetje të ligjit Nr.7491, dt.29.04.1991, neni.45, pika.17.

VENDOSI

1. Të miratojë vendimin e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve për të emëruar Shtëpin Botuese Enciklopedike me emrin “Faik Konica”.
2. Gjimnazi me emërtimin jo zyrtar DEMOKRACIA ti rihet emri i mëparshëm i shkollës (në po këtë godinë) “Luigj Gurakuqi”, duke ruajtur në sistemin e emërtimeve të shkollave emrin e patriotit Luigj Gurakuqi.
3. Sheshi përpara Fakultetit të Stomatologjis të emërtohet Sheshi “Hafiz Ibrahim Dalliu”.
4. Rruga “Sermedin Seid Toptani” të ndryshojë duke u quajtur Rr.”Abdi Toptani”.
5. Rruga para Teatrit Kombëtar të emërohet “Sermedin Said Toptani”.

6. Rruga para Galerisë Kombëtare të Arteve emërohet Rr. "Murat Toptani".
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
8. Për zbatimin e tij ngarkohet Seksioni i Kulturës.

KRYETARI

BESNIK PETRELA